

progetto cofinanziato da



UNIONE
EUROPEA

Milano



Comune
di Milano

Assessorato Famiglia Scuola
e Politiche Sociali



MINISTERO
DELL'INTERNO



COME...

*Percorsi di accoglienza, integrazione,
educazione interculturale*



Fondo europeo per l'integrazione di cittadini di paesi terzi

AI GENITORI STRANIERI

PRINDËRVE TË HUAJ

Come funziona la scuola secondaria di primo grado in Itali

Si funksionon shkolla dytësore e shkalles së parë

në Itali


Italiano/albanese/shqip

12 prime informazioni per l'accoglienza dei vostri figli

12 Informacionet fillestare për mikpritjen e fëmijëve tuaj

Aprile 2011

Prill 2011



BENVENUTI nel nostro paese e nelle nostre scuole

Prima di tutto diciamo a voi e ai vostri figli “Benvenuti” in Italia e nella scuola italiana.
Vi diamo poi alcune informazioni sulla scuola secondaria di primo grado, comunemente chiamata scuola media.

Iscrivete i vostri figli subito anche se l'anno scolastico è già cominciato e ricordate che tutti i ragazzi hanno diritto ad andare a scuola anche se non sono in regola con le norme sul soggiorno (ONU, Convenzione Internazionale sui Diritti dell'Infanzia, Art. 28 e DPR 394/99

MIRËSEVINI në vendin tone dhe në shkollat tona

Para së gjithash ju themi ju dhe fëmijëve tuaj “Mirësevini” në Itali dhe në shkollën italiane.
Ju japim disa informacione për shkollën dytësore të shkallës së pare, ose si quhet më thjesht tetëvjeçare ose cikli i mesëm i ulët.

Rregjistroni menjëherë fëmijët tuaj edhe nëse viti shkollor tashmë ka filluar dhe kini parasysh se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë edhe nëse nuk janë në rregull me ligjet mbi qëndrimin (OKB, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve , Neni 28 dhe DPR 394/99).

1. QUANTI ANNI DURA LA SCUOLA IN ITALIA?

1. SA VJET ZGJAT SHKOLLA NE ITALI?

Asilo nido	fino a 3 anni
Scuola dell'infanzia	da 3 a 6 anni
Scuola primaria	da 6 a 11 anni
Scuola secondaria di 1° grado	da 11 a 14 anni
Scuola secondaria di 2° grado	oltre 14 anni

Il primo ciclo d'istruzione dura 8 anni:

- 5 anni di scuola primaria
- 3 anni di scuola secondaria di primo grado (scuola media)

Si conclude con un esame finale.

Dopo la scuola secondaria di primo grado l'alunno deve proseguire gli studi con la frequenza almeno della prima e della seconda classe della scuola secondaria di secondo grado.

L'obbligo d'istruzione in Italia dura 10 anni, fino a 16 anni di età.

L'iscrizione alla scuola è gratuita. I libri di testo non sono gratuiti e devono essere acquistati dalla famiglia. Anche l'occorrente scolastico (quaderni, penne, colori, ecc.) deve essere acquistato dall'alunno.

Gli alunni in difficoltà economiche hanno la possibilità di ottenere in prestito i libri per l'anno scolastico.

Chiedete informazioni alla segreteria della scuola.

Çerdhja	deri në 3 vjeç
Shkolla e fëmijërisë (kopshti)	nga 3 deri në 6 vjeç
Shkolla fillore	nga 6 deri në 11 vjeç
Shkolla dytësore e shkallës së parë (cikli i mesëm i ulët)	nga 11 deri në 14 vjeç
Shkolla dytësore e shkallës së dytë (cikli i mesëm)	mbi 14 vjeç

Cikli i parë i shkollimit zgjat 8 vjet :


- 5 vjet të shkollës fillore
- 3 vjet të shkollës dytësore të shkallës së parë (cikli i mesëm i ulët). Mbaron me një provim përfundimtar.

Mbas shkollës dytësore të shkallës së parë, nxënësit duhet të ndjekin të paktën vitin e parë dhe të dytë të shkollës dytësore të shkallës së dytë. Arsimi në Itali është i detyruar për 10 vjet studimi, deri sa studenti mbush 16 vjeç.

Rregjistrimi në shkollë është falas. Tekstet shkollore nuk janë falas dhe duhen blerë nga familja. Edhe materialet shkollore (fletoret, penat, ngjyrat, etj..) duhet të blihen nga nxënësit.

Nxënësit që kanë vështirësi ekonomike mund të marrin në përdorim për vitin shkollor tekstet.

Kërkoni informacion tek sekretaria e shkollës.



2. QUALI DOCUMENTI CI VOGLIONO PER ISCRIVERE I RAGAZZI ALLA SCUOLA MEDIA SECONDARIA DI PRIMO GRADO?

2. ÇFARË DOKUMENTASH DUHEN PËR TË RREGJISTRUAR FËMIJËT NË SHKOLLËN DYTËSORE TË SHKALLË SË SË PARË?

Per iscrivere il ragazzo a scuola il genitore deve compilare il modulo fornito dalla Segreteria. In esso autocertifica la data di nascita dell'alunno e tutte le altre informazioni richieste.

Se ha i seguenti documenti:

- certificato di nascita
- certificato di vaccinazione
- dichiarazione della scuola frequentata nel paese di origine li può consegnare alla Segreteria.

Al momento dell'iscrizione si compilano i moduli per:

- la scelta del tipo di scuola (vd. numero 3)
- l'insegnamento della religione cattolica (vd. numero 6)
- l'iscrizione alla refezione scolastica (vd. numero 4)

Se non avete il certificato di vaccinazione rivolgetevi all'assistente sanitaria della scuola che vi dirà che cosa fare.

Për rregjistrimin e fëmijës, prindi duhet të plotësoje një formular i cili jepet në Sekretari. Aty ju vetëdeklaroni datëlindjen e fëmijës dhe të gjitha informacionet e kërkuara.

Nëse jeni të pajisur me dokumentet e mëposhtme:


- certifikatë lindje
- librezën e vaksinave
- deklaratën e lëshuar nga shkolla që nxënësi ka ndjekur në vendin nga vjen

mund t'i dorëzosh në Sekretari.

Në momentin e rregjistrimit duhet të plotësohen formularët për:

- zgjedhjen e tipologjisë së shkollës (shih numrin 3)
- mësimin e fesë katolike
- rregjistrimin për mensën (shih numrin 4)

Ne rast se nuk keni certifikatën e vaksinave, drejtohuni ndihmëses sanitare, e cila ju tregon se si duhet të veproni.



3. QUALE TIPO DI SCUOLA SECONDARIA DI PRIMO GRADO? 3. ÇFARE TIPOLOGJI TË SHKOLLËS DYTËSORE TË SHKALLËS SËPARË?

In molte scuole i genitori possono scegliere fra due possibilità di orario e di organizzazione scolastica:

- **la scuola a “tempo normale”:**

è di 29 ore settimanali obbligatorie + 33 ore annuali di approfondimento,
dal lunedì al venerdì: dalle 8.15 alle 13.15.

- **la scuola a “tempo prolungato”:**

prevede fino a 36/40 ore settimanali con dei rientri pomeridiani e, in alcune scuole, il tempo dedicato alla mensa.

Chiedete subito l'orario della classe di vostro figlio.

Në shumë shkolla prindërit mund të zgjedhin ndërmjet dy mundësive të orarit dhe organizimit shkollor:

- **klasa me “ orar normal”:**

është me 29 orë në javë të detyruara + 33 orë në vit për studime,
nga e hëna deri të premten: orari 8.15 deri 13.15.

- **klasat me “orar të zgjatur”:**

parashikon deri 36/40 orë në javë me rikthim pasdite. Në disa shkolla duhet shtuar edhe koha e dedikuar mensës.

Kërkoni menjëherë orarin e mësimave të fëmijës tuaj.



4. COME SI ISCRIVONO I RAGAZZI ALLA REFEZIONE?

4. SI RREGJISTROHEN NXËNËSIT PËR TË FREKUENTUAR MENSËN ?

In alcune scuole vi è il servizio di refezione scolastica. I genitori pagano per il pranzo una retta diversa secondo il reddito della famiglia.

E' possibile chiedere una dieta speciale per motivi di salute o per motivi religiosi.

Per iscriversi alla refezione scolastica si deve compilare il modulo prestampato che viene consegnato dalla Segreteria Comunale.

Se il genitore chiede la riduzione della retta della refezione scolastica, deve compilare un modulo che gli verrà consegnato dalla segreteria.

Occorre presentare la carta d'identità del genitore (o il passaporto).

Alla segreteria della scuola si consegnano

- il documento ISEE (rilasciato dal comune)
- la richiesta di dieta speciale per motivi religiosi o di salute.

Per eventuali domande o per qualsiasi altro problema rivolgetevi alla segreteria della scuola.

Në disa shkolla ofrohet shërbimi i mensës.

Prindërit paguajnë për drekë një kuote në bazë të të ardhurave të familjes.

Është e mundur të kërkohet një diete speciale për motive shëndeti ose fetare.

Për tu rregjistruar në shërbimin e mensës duhet të plotësohet formulari që ju dorëzohet nga Sekretaria e Komunës.

Nëse prindi kërkon reduktimin e kuotës së pagesës së mensës, duhet të plotësojë një formular që i dorëzohet nga sekretaria.

Duhet të paraqitet edhe letërnjoftimi i prindit (ose pasaporta).

Në sekretarinë e shkollës duhen paraqitur

- Dokumenti ISEE (i lëshuar nga komuna)
- Kërkesa për dietën speciale për motiv fetar ose shëndeti.

Në rast pyetjesh ose problemesh drejtohuni sekretarisë së shkollës.




5. CI SONO ATTIVITÀ EXTRA-SCOLASTICHE? 5. A ZHVILLOHEN AKTIVITETE JASHTËSHKOLLORE?

In molte scuole medie vengono organizzate attività sportive (pallavolo, basket) o di altro tipo (teatro, lingua latina ecc.) a costi contenuti.

Informatevi presso la segreteria o chiedendo direttamente al Preside o agli insegnanti

Në shume shkolla dytësore të shkallës së parë organizohen aktivite sportive (volejball, basketboll) ose te llojeve të tjera (teatër, gjuha latinishte etj..) me çmime të arsyeshme

Informohuni pranë sekretarisë ose drejtohuni drejtpërdrejt Drejtorit ose mësuesve.



6. INSEGNAMENTO DELLA RELIGIONE CATTOLICA O SCELTA ALTERNATIVA? 6. MESIMI I FESE KATOLIKE APO ZGJEDHJE ALTERNATIVE?

Per un'ora alla settimana è previsto l'insegnamento della religione cattolica.

Al momento dell'iscrizione i genitori devono dichiarare se scelgono di:

Avvalersi

Non avvalersi

di tale insegnamento.

Se i genitori decidono di non far studiare la religione cattolica ai loro figli devono scegliere tra 3 possibilità alternative:

- attività didattiche e formative
- attività di studio e/o di ricerca individuale
- non frequenza della scuola nelle ore di religione (entrata posticipata/uscita anticipata)

Një ore në javë parashikohet mësimi i fesë katolike .
Në momentin e regjistrimit prindi duhet te deklarojë zgjedhjen:


Të ndjekë

Të mos ndjekë

mësimin e fesë katolike.

Në rast se prindërit zgjedhin që fëmija të mos ndjekë mësimin e fesë duhet të vendosin për këto 3 alternativa :

- aktivitetet mësimore dhe formuese
- aktivitete studimi / ose kërkimi individual
- të mos frekuentojë shkollën në orët e fesë (të arrijë me vonë ose të dalë para kohe)



7. QUAL È IL CALENDARIO SCOLASTICO? 7. CILI ËSHTË KALENDARI SHKOLLOR ?

La scuola dura circa 9 mesi.
Comincia verso la metà di settembre e finisce a metà giugno.

Ci sono due periodi di vacanza:

- due settimane a Natale (di solito dal 23 dicembre al 6 gennaio)
- circa una settimana a Pasqua (in marzo o in aprile).

Altri giorni di vacanza sono distribuiti durante l'anno e dipendono dalle decisioni delle singole scuole.

*La scuola vi informerà ogni volta di eventuali giorni di chiusura della scuola con un avviso sul diario di vostro figlio.
Controllate sempre il diario!*

Assenze

Ogni assenza deve essere sempre giustificata dai genitori.
Anche quando l'alunno entra a scuola in ritardo o deve uscire in anticipo, deve presentare una giustificazione firmata dai genitori.

Shkolla zgjat rreth 9 muaj.

Fillon në mes të shtatorit dhe mbaron në mes të qershorit.

Ka dy periudhaa pushimesh:

- dy javë për krishtlindjet (zakonisht 23 dhjetor deri në 6 janar)
- rreth një jave për pashkët (në maj ose në prill).

Ditë të tjera pushimesh janë të shpërndara gjatë gjithë vitit shkollor dhe varen nga secila shkollë.

Shkolla do t'ju informojë në çdo rast nëpërmjet një lajmërimi në ditarin e fëmijës tuaj.

Kontrolloni gjithmonë ditarin !

Mungesat

Çdo mungesë duhet të justifikohet nga prindi.

Edhe kur nxënësi hyn ne shkolle me vonese ose do të dale para kohe, duhet të paraqitet një justifikim nga prindërit.

8. CHE COSA IMPARANO I RAGAZZI A SCUOLA? 8. ÇARË MËSOJNË FËMIJËT NË SHKOLLË ?

Nella scuola secondaria di primo grado i ragazzi studiano:


- Italiano, storia, geografia
- Attività di approfondimento in materie letterarie
- Matematica e scienze
- Tecnologia
- Inglese
- Seconda lingua comunitaria
- Informatica
- Arte e immagine
- Scienze motorie e sportive
- Musica
- Religione cattolica (opzionale)

Per gli alunni stranieri neo-arrivati è possibile utilizzare le 2 ore della seconda lingua comunitaria per potenziare l'insegnamento della lingua italiana

Në shkollën dytësore te shkalles se pare nxënësit studiojnë:

- Gjuhën italiane, histori, gjeografi
- Aktivitete studimi në letërsi
- Matematikë dhe shkencë
- Teknologji
- Gjuhën angleze
- Një gjuhë të dytë të folur në Evropën e bashkuar
- Informatikë
- Art dhe arte figurative
- Shkencat e lëvizjes dhe sportit
- Muzikë
- Mësim feje (mund të zgjidhni)

Për nxënësit e sapo ardhur është e mundur që në 2 orët e gjuhës së dytë të huaj të forcojë mësimin e gjuhës italiane.



9. COME VENGONO VALUTATI I RISULTATI SCOLASTICI? 9. SI VLERËSOHEN REZULTATET SHKOLLORE?

Ogni anno scolastico è diviso in due parti (2 quadrimestri): da settembre a gennaio e da febbraio a giugno.

A gennaio e a giugno gli insegnanti fanno una valutazione dei risultati scolastici degli alunni e preparano un “documento di valutazione” che viene consegnato alla famiglia.

Le valutazioni sono espresse in decimi con i numeri da 1 a 10. Sono promossi, cioè ammessi alla classe successiva, gli alunni che hanno i voti dal 6 al 10. Anche la valutazione del comportamento è espressa con voto numerico.


Durante il quadrimestre ci sono dei compiti in classe che servono a dare la valutazione del 1° e del 2° quadrimestre.

Viti shkollor ndahet në dy pjese: (2 katërmujorë) :
Nga shatori në janar dhe nga shkurti në qershor.

Në janar dhe në qershor mësuesit vlerësojnë rezultatet shkollore të nxënësit dhe përgatisin një “dokument vlerësimi” që i dorëzohet familjes.

Vlerësimi shprehet me vlerën numerike nga 1 deri ne 10. Kalojnë klasën dhe pranohen ne klasën e mësipërme nxënësit që kane notat nga 6 deri ne 10. Edhe për sjelljen vlerësimi shprehet nëpërmjet notave.

Gjate katërmujorit parashikohen provime në klasë që shërbejnë për të dhëne vlerësimet e katërmujorit të parë dhe të dytë.



10. A CHE COSA SERVONO LE RIUNIONI TRA I GENITORI E GLI INSEGNANTI? 10. PËRSE JANË TË RËNDËSISHME MBLEDHJET PRINDËR MËSUES?

Gli insegnanti periodicamente incontrano i genitori per parlare con loro del programma della classe, dei progressi e delle difficoltà dei ragazzi.

Questi momenti di incontro sono molto importanti perché la scuola e la famiglia possono collaborare per l'educazione degli alunni e il loro buon inserimento.

Colloqui

Ogni insegnante comunica ai genitori il giorno in cui li può incontrare per parlare del ragazzo.

Anche i genitori possono chiedere un colloquio con gli insegnanti.

Se volete parlare di vostro figlio chiedete subito un colloquio agli insegnanti.

Mësuesit në mënyre periodike takohen me prindërit për të folur me ta mbi programin shkollor, për fëmijët, vështirësitë dhe progresin e tyre.


Këto takime janë shumë të rëndësishme sepse shkolla dhe familja mund të bashkëpunojnë për edukimin e fëmijëve dhe integrimin e tyre.

Bisedat

Çdo mësues i komunikon prindërve ditën në të cilën mund të takohen për të folur për fëmijët e tyre.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një takim me mësuesit.

Nëse dëshironi të flisni për fëmijët tuaj kërkonijë menjëherë një takim me mësuesit.



11. SE IL RAGAZZO NON SA L'ITALIANO? 11. KUR NEXËNESI NUK FLET ITALISHT?

Per aiutare vostro figlio a inserirsi nella classe e per insegnargli la nuova lingua, gli insegnanti organizzeranno dei momenti individualizzati e di gruppo e delle attività di insegnamento dell'italiano orale e scritto.

In alcune scuole vi sono degli insegnanti specialisti che hanno il compito di insegnare l'italiano agli alunni stranieri, riunendoli in piccoli gruppi. Vi è anche la possibilità di utilizzare 2 ore della seconda lingua comunitaria per imparare l'italiano.

Për të ndihmuar fëmijën tuaj të mësoje gjuhën e re, mësuesit do të organizojnë momente individuale ose me grupe të vegjël për aktivitetet e mësimit të gjuhës italiane të folur dhe të shkruar .

Në disa shkolla janë të pranishëm mësues të specializuar që kanë detyrë të mësojnë italishten nxënësve të huaj, nëpërmjet grupeve të vogla për disa orë në javë.

Është e mundur që 2 orët e gjuhës së dyte të huaj të përdoren për mësimin e gjuhës italiane.



12. E SE NE VOLETE SAPERE DI PIÙ? NESE DONI TE DINI ME TEPER?

Non preoccupatevi!

Ci sono infatti dei centri che vi possono dare suggerimenti concreti:

- Via Tarvisio 13
tel 02 88448246 - 02 88448248
(Sportello informativo, Segretariato e servizio sociale, Pronta accoglienza, Orientamento al lavoro e formazione)
- Via Barabino 8
Tel. 02 88445453 - 02 55214981
(Sportello Centri di accoglienza, Sportello Richiedenti Asilo e Rifugiati, Orientamento e consulenza giuridica)
- Via Edolo 19
Tel. 02 88467581
(Interpretariato, Documentazione)
- USP /Centro Servizi Amministrativi
Via Ripamonti, 85
201141 Milano
Tel. 02 56666.1
uspmi@postacert.istruzione.it
- Centro Come
Via Galvani, 16
20124 Milano
Tel. 0267100792
www.centrocome.it
come@farsiprossimo.it ; info@centrocome.it

Naturalmente ci sono genitori stranieri che possono aiutarvi!!!

Mos u shqetësoni!

Ka disa qendra që mund t'ju japin këshilla konkrete

- Via Tarvisio 13
Tel. 02 88448246 - 02 88448248
(Sportel informacioni, Sekretari për shërbimin social, Mirëpritjen , Orientim për punën dhe formimin)
- Via Barabino 8
Tel. 02 88445453 - 02 55214981
(Sportel për Qendrat e mirëpritjes, Sportel për Personat qe kërkojnë Azil ose Refugjatet, orientim dhe konsulencë juridike)
- Via Edolo 19
Tel. 02 88467581
(Përkthim dhe Dokumenta)
- USP /Qendra e Shërbimit Administrativ
Via Ripamonti, 85
201141 Milano
Tel. 02 56666.1
uspmi@postacert.istruzione.it
- Qendra Come
Via Galvani, 16
20124 Milano
Tel. 0267100792
www.centrocome.it
come@farsiprossimo.it ; info@centrocome.it

Natyrisht ka edhe prindër të huaj që mund t'ju ndihmojnë!!

Questo fascicolo è tradotto in 15 lingue:

Albanese
Arabo
Bangla
Cinese
Cingalese
Francese
Hindi
Inglese
Portoghese
Rumeno,
Russo
Spagnolo,
Tagalog
Turco
Ucraino

Ky fashikull është përkthyer në 15 gjuhë:

Shqipe
Arabishte
Bangla
Kineze
Singaleze
Franceze
Indiane
Angleze
Portugeze
Rumune
Ruse
Spanjolle
Tagalog (gjuha e folur ne Filipine)
Turqishte
Ukraine

*** LA RIPRODUZIONE VIENE INCORAGGIATA CITANDO LA FONTE**

*** RIPRODHIMI INKURAJOHET DUKE PËRMENDUR PREJARDHJEN**

**BUONA SCUOLA!
MËSIM TË MBARË!**

Progetto originale:

Angela Plazzotta

Rielaborazione:

Marina Carta

Michela Casorati

Centro COME

Cooperativa Farsi Prossimo

Traduzioni:

Progetto Mediante – Comune di Milano

Almira Myzyri

Disegni:

Benedetta Marasco

Projekti origjinal:

Angela Plazzotta

Rishikimi :

Marina Carta

Michela Casorati

Qëndra COME

Kooperativa Farsi Prossimo

Përkthimet:

Projekti Mediante – Komuna e Milano-s

Almira Myzyri

Illustrimet:

Benedetta Marasco